

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “GS Albania “SH.P.K

Ne baze te ligjit nr.9723 date 03.05.2007, te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore ne fuqi une i nenshkruari **Edmond Kristo**, me atesi Thoma, datelindja 02.07.1963, lindur ne Elbasan dhe banues ne Elbasan,Rajoni 1, lagjia “Kongresi i Elbasanit”, Pall.20, mbajtes i leternjoftimit me nr.personal G30702154U, themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **“GS Albania“ sh.p.k.**

N E N I 1

Shoqeria e ka emrin “GS Albania” sh.p.k me ortak te vetem te saj z.Edmond Kristo. Organi drejtues i shoqerise “GS Albania” sh.p.k eshte ortaku dhe administratori i saj. Admistrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i saj z.Edmond Kristo.Koha e qendrimit ne detyre te administratorit eshte pese vjecare me te drejte rizgjedhje.

N E N I 2

Shoqeria “GS Albania” sh.p.k gezon statusin e personit juridik.Veprimtaria ekonomike dhe financiare e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te ketij akt themelimi, statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.Statuti i Shoqerise i bashkengjitet ketij akt themelimi dhe eshte pjese perberese e saj dhe e dokumentacionit te shoqerise.

N E N I 3

Shoqeria “GS Albania” sh.p.k eshte person juridik dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese.Shoqeria e ushtron veprimtarine saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj, akti i themelimit dhe ne statutin e saj.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

N E N I 5

Selia e shoqerise “GS Albania” sh.p.k eshte ne qytetin e Elbasanit, Lagja Partizani, Rruga Janaq Kilica nr.10, Kati 3.

Shoqeria mund te hape filiale, dege, perfaqesi ose agjensi ne varesi te saj ne te gjithë teritorin e Republikes se Shqiperise ne çdo kohe qe te çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kopetente.

N E N I 6

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke i formuar teresisht nga ortakut i vetem i saj. Numri i kuotave eshte 1(nje) kuote. Numri i pjeseve eshte 1(nje) pjese dhe Vlera nominale e nje pjese eshte 100.000 leke.

Ortakut i vetem i shoqerise mund te rrisë kapitalin e shoqerise dhe ta pasqyroje ate ne regjistrin tregëtar.



N E N I 7

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ekonomike:
Dizenjim dhe projektim dyqane dhe showroom per automjete, motoçikleta dhe motorre.
Punime karrocierie dhe autooficine, tregtim i produkteve te ngjashme dhe qe lidhen me to.
Import-Eksport, Importim, eksportim dhe tregtim i automjeteve , motoçikletave, biçikletave me dy, tre dhe kater rrota, te reja dhe te perdorura, te markave Piaggio, Vespa, Gilera, Aprilia, Moto Guzzi, Dervi si dhe te markave te tjera, pjeseve te kembimit, aksesoreve, apparel, merchandising, servis te specializuar per te gjitha automjetet, motoçikletat dhe biçikletat e markes Piaggio, Vespa, Gilera, Aprilia, Moto Guzzi, Derbi si dhe te markave te tjera.
Tregtim te produkteve kunder zjarrit dhe te sigurise ne sektorin privat dhe publik.
Projektimi dhe realizimi i fushave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytezimit te te gjitha instrumentave, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingut direkt. Projektimi, realizimi dhe shitblerja e sherbimeve call-center, si inbound dhe outbound.
Projektimi, administrimi dhe shitblerja e produkteve dhe sherbimeve telematike, informatike dhe te marketingut, ne fushen telefonike, informatike dhe tregtare si dhe shitblerja e te gjithe produkteve dhe sherbimeve te lidhura me to.

Per kryerjen e aktiviteteteve te shoqerise per te cilat nevojitet leje perkatese shoqeria eshte e detyruar te paiset paraprakisht me leje perkatese nga organi kopetent.

N E N I 8

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise, sipas legjislacionit shqiptar, aktit te themelimit per krijimin e shoqerise dhe statutit te shoqerise.

N E N I 9

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne Statutin e saj.
Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje te njejta origjinale per t'iu shperndare organeve kompetente ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise.

N E N I 10

Ky akt themelimi nenshkruhet ne Elbasan sot me date 08.03.2018.

**ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM
I SHOQERISE "GS Albania" SH.P.K.**

Edmond Kristo

